



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.247/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) i përbërë nga gjyqtarët: Ymer Hoxha kryesues, Muhamet Rexha dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Rexhep Canollit, rruga “Bajram Bahtiri” në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), për shkak se gjendet emëri i personit të vdekur në listën përfundimtare të votuesve (LPV), në seancën e panelit të mbajtur me dt. 09.06.2014, mori këtë:

### VENDIM

**Hidhet e palejuar ankesa e Rexhep Canollit .**

### Arsyetim

Me datën 08.06.2014, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Rexhep Canolli, në të cilën theksohet se me rastin e votimit në vendvotim, në Libërin e Votimit e ka gjetur emërin e nënës së ndjerë Hafije Canollit.

Parashtruesi i ankesës ka kërkuar që të merren masa ligjore ndaj këtyre personave. Në cilësi të provës e ka bashkangjitur leje njoftimin e Hafije Canollit.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës gjeti se :

### **ankesa është e palejuar**

PZAP-i, konstaton se pretendimet ankimore, janë të palejuara që të paraqiten në PZAP, sepse PZAP-i është institucion që vendos për vendimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) sipas nenit 122 par.1 pikat a, b, c, d, e dhe f, meqenëse në asnjërin nga pikat e lartpërmendura të dispozitës nuk kanë rënë pretendimet e parashtruara në ankesë. Andaj PZAP-i, nuk u lëshua fare në shqyrtimin e kësaj çështje pasi që nuk është në juridiksionin e këtij institucioni që të vendos për largimin e personave të vdekur që gjenden në Listat Përfundimtare të Votuesve (LPV), në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë**

Anr. 247/2014 më datën 09.06.2014



### ***Udhëzim Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*